



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 53/2012
Prishtinë, më 07.03. 2012, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Sala Berisha – Shala, Berat Buzhala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Myzejene Selmani dhe Visar Ymeri.

Munguan: Teuta Sahatqija, Fikrim Damka dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Avdi Kamerolli- MI; Arianit Islami –AAC; Ukë Gashi - ZRPK; Gëzim Kolgeci dhe Ardian Kryeziu -USAID/BEEP dhe Isuf Zejna- KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.02.2012;
3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike;
4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Projektligjit nr. 04/L- 098 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që pika e 3 (tretë) e rendit të ditës “Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike” të kalojë si pika e 4 (katërt) e rendit të ditës, derisa të jetë i pranishëm z. Hashim Deshishku, si raportues i grupit punues.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.02.2012

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 28.02.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Projektligjit nr. 04/L- 098 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror

Kryetari – Tha se për këtë pikë të rendit të ditës kemi raportuesen, zonj. Sala Berisha-Shala për raportim në lidhje me këtë projektligj.

Sala Berisha –Shala - Theksoi që grupi punues e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-098 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror dhe ka pasur disa takim pune, si dhe një Dëgjim publik, ku i ka shqyrtuar propozimet dhe sugjerimet e ardhura nga të gjitha institucionet që i kanë sjellë siç janë: Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”, KFOR-i dhe Shoqëria Civile (INDEP). Pas shqyrtimit dhe analizimit të propozimeve grupi punues ka nxjerrë 21 amendamente. Dhe, pastaj prezantoj 21 amendamentet duke arsyetuar secilin një për një.

Berat Buzhala - Për amendamentin 8, të nenit 5 tha se për Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror është mirë të mbetet si Agjenci që i raporton Kuvendit dhe jo Qeverisë, sikurse agjencitë e tjera të pavarura.

Sala Berisha –Shala – Sqaroi se për shkak të specifikave që ka kjo agjenci kemi vendosur që të jetë nën ministrinë përkatëse, sepse dhe emërohet nga Qeveria me propozim të ministrit.

Lutfi Zharku – Theksoi se kjo është një agjenci ekzekutive dhe ne kemi vendosur që të këtë një raportim të ministrit të ministrisë përkatëse për infrastrukturë, ndërsa raportin vjetor ta miratojë Qeveria, sepse edhe ashtu procedura e emërimit të drejtorit të kësaj agjencie.

Visar Ymeri – Tha se është më mirë që kjo agjenci të jetë nën përgjegjësit e ministrisë përkatëse dhe Qeverisë, sepse ka kompetenca ekzekutive.

Propozimi nuk u miratua.

Berat Buzhala - Për amendamentin 9, të nenit 6 theksoi se në kushtet që duhet të plotësojë një drejtor duhet të këtë edhe kushtin e “gjuhës angleze” dhe të jetë i “certifikuar me licencën e kontrollorit të trafikut ajror ose certifikimin relevant në një fushë të ngjashme” për shkak të specifikave që duhet të këtë një pozitë e tillë.

Lutfi Zharku – Theksoi se është e panevojshme të cekën kushtet formale të cilat nuk ka nevojë të vendoset në ligj.

Sala Berisha –Shala – Sqaroi se gjuha angleze nuk është gjuhë zyrtare dhe kjo është diçka që nënkuptohet, andaj e kemi pa të paarsyeshme të cekim në ligj.

Komisioni vendosi që në paragrafin 1, të nenit 6 të shtohet teksti “ se paku të plotësohen kushtet në vijim”.

Myzejene Selmani – Propozoi që nënparagrafi 1, i nenit 6 të mbetet sikurse në projektligj.

Propozimi u përkrah nga Komisioni.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 04/L- 098 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror

4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike

Hashim Deshishku - Theksoi se për Projektligjin nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike, ka mbetur një çështje e hapur te neni 23, ku për këtë nen Ministria Tregtisë dhe Industrisë i ka dërguar ndryshimin, lidhur për emërtimin nga “Organizata Nacionale Turistike e Kosovës” të quhet “Këshilli i Turizmit të Kosovës” dhe ka sjellë disa propozime për të fshirë nenet e ligjit bazik. Ai shtoi se pas konsultimit me stafin e Komisionit, kemi marrë këshillën juridike që propozimet për të fshirë nenet e ligjit bazik nuk mund të shqyrtojmë, sepse janë në kundërshtim me ligjin për nismat legislative për shkak se në kemi objekt shqyrtimi projektligjin e jo ligjin bazik.

Pas debatit Komisioni u pajtua që ti “Organizata Nacionale Turistike e Kosovës” të quhet “Këshilli i Turizmit të Kosovës”.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike.

5. Të ndryshme

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit